

Organizatat ndërkombëtare mbështeten në standardin e **ECDL-së**



www.ecdl-kosova.org

ECDL – Kthim i menjëhershëm i investimit

Domosdoshmëria e përdorimit të teknologjisë informative në prodhim dhe shërbime është kuptuar nga shumica e kompanive dhe punëdhënësve. Shuma të panumërta parash janë shpenzuar nga bizneset për t'u pajisur me kompjuterë dhe softuerë, në mënyrë që punonjësit e tyre të mund t'i kryejnë punët e tyre në mënyrë më efektive dhe efkase.

Megjithatë, aftësia e punonjësve për ta përdorur këtë teknologji është marrë shpesh si e garantuar. Edhe në rastet kur trajnimi u është ofruar punonjësve, përgjithësisht nuk ka pasur verifikim të kompetencës së tyre për ta përdorur këtë teknologji.

Duke inkurajuar punonjësit që të certifikohen me ECDL, kompanitë mund të sigurohen që punonjësit e tyre i kanë aftësitë e nevojshme për përdorimin e kompjuterëve dhe softuerëve në mënyrën më efektive të mundshme.

Programet certifikuese të ECDL-së përdoren për të rritur vlerën e kapitalit human dhe për të arritur përfitime në produktivitet nëpërmjet zhvillimit të punonjësve, të aftë për punë me kompjuterë dhe aplikacione softuerike.

„ECDL NUK ËSHTË THJESHTË NJË KUALIFIKIM SHITESË , POR NJË PARAKUSHT QË DUHET PLOTËSUAR PËR TË PUNUAR NË KOMPANI“

Dr. Michael Gorriz, CIO në Mercedes-Benz

Rritje e produktivitetit

Punonjësit e certifikuar me ECDL kanë treguar aftësi për të përdorur shumicën e aplikacioneve të rëndomta softuerike në mënyrë korrekte dhe efikase. Kjo u mundëson atyre për të kompletuar detyrat në mënyrë më të shpejtë dhe më të saktë.

Këtë e dëshmojnë edhe disa studime të pavarura, të ndërmarra në vende të ndryshme.

Studimi "Kostoja e Injorancës" i kryer nga AICA (Associazione Italiana per l'Informatica ed il Calcolo Automatico) në vitin 2003 në Itali, mati masën e ndryshimit të produktivitetit dhe reduktimin e kostove të fshehura për shkak të certifikimit me ECDL. Studimi gjeti që trajnim-certifikimi ECDL rezultoi në një mesatare prej 10% zvogëlim të kohës së shpenzuar në kryerjen e punëve me kompjuter dhe 47% rritje të kompetencës nga niveli që ishte para trajnimit. Rikthimi i investimit nga programi i certifikimit ECDL ishte €2,261 për person në vit.

Studimi i kryer në Norvegji nga Ernst & Young në 2001 zbuloi që duke certifikuar stafin me ECDL, punëdhënësit mundet mesatarisht të rifitojnë 3 orë pune në javë për secilin punonjës.

Organizatat me punonjës të kualifikuar e përdorin teknologjinë për ta rritur produktivitetin e tyre dhe për të qëndruar konkurruese në treg. Studimet kanë treguar që organizatat të cilat kanë përdorur certifikimet e ECDL-së në mënyrë të suksesshme për stafin e tyre, kanë përfituar 8% rritje në produktivitet.



Motivim dhe zhvillim i personelit

Natyra progresive e ECDL-së për zhvillimin e shkathtësive digjitale dhe njohja e mësimit paraprak, i inkurajon punonjësit për të zhvilluar dhe forcuar aftësitë e tyre kompjuterike dhe krijon një mjedis më të motivuar pune. Provimet e ECDL-së organizohen për secilin modul, gjë e cila mundëson organizimin e certifikimit konform nevojave të kompanisë dhe punëtorëve tuaj. Prandaj, ju mund të përqendrohni vetëm në modulet të cilat iu nevojiten punëtorëve tuaj për ta kryer punën e tyre në mënyrë efikase.

Korporatat multinacionale (KPMG, Ernst & Young, GEC-Marconi, Nortel, Pfizer, Waterford-Wedgewood, Shell, Banka e Irlandës, IBM, Xerox, Volkswagen, Raiffeisenbank, Toyota, DHL, etj.) tashmë e kanë miratuar licencën e ECDL-së, duke e vendosur atë si pikë referimi të performancës që ata presin prej të punësuarve të tyre.

Institucione arsimore të njohura botërisht (Oxford University, Trinity College, University College Dublin, Universiteti i South Wales, Universiteti i Dundee, etj) e kanë adaptuar programin mësimor dhe licencën e ECDL-së dhe ofrojnë testimin dhe trajnimin për fakultet, staf dhe studentë.

"TË GJITHË NXËNËSIT DHE PRAKTIKANTËT QË DËSHIROJNË T'IA SIGUROJNË VETES NJË VEND PUNE DO TË DUHEJ TA ABSOLVONIN ECDL-NË NË VITIN E PARE TË STUDIMEVE"

Julia Röhl, Udhëheqëse e departamentit të trajnimeve në ThyssenKrupp Nirosta

Më pak probleme me PC

Njohuritë e pamjaftueshme në përdorimin e kompjuterit shpeshherë rezultojnë në punë joproduktive dhe të pakënaqshme. Shumica e problemeve me PC, të cilat trajtohen nga personeli ndihmës i IT-së, mund të shmangen nëse punonjësit i përmirësojnë aftësitë e tyre kompjuterike. Duke edukuar punonjësit sipas standardit të ECDL-së, kompanitë zbulojnë se ata do të përjetojnë më pak probleme të ndërlidhura me PC dhe si rrjedhojë kërkojnë më pak mbështetje. Në këtë mënyrë ekipet e IT Help Desk do të mund të shndërroheshin në një burim më strategjik për organizatën dhe në vend se të merreshin me zgjidhjen e problemeve rutinore do të fokusoheshin në përcjelljen e teknologjisë dhe inovacionit.

Njohje ndërkombëtare

ECDL është zhvilluar fillimisht si përgjigje ndaj nevojave të industrisë në të gjithë Evropën. Ajo është e njohur tani si standard ndërkombëtar i kompetencës për përdoruesit e kompjuterit. UNESCO e ka miratuar atë si pjesë të Kornizës së Kurrikulumit të Informatikës. Shumica e Qeverive Evropiane dhe më gjerë e bazojnë zhvillimin e shkathtësive digjitale të punonjësve publik, nxënësve dhe studentëve në sillabuset e ECDL-së dhe e përdorin certifikimin e ECDL-së si standard për matjen e nivelit të digjitalizimit të tyre.

Certifikatat e ECDL-së mund të përdoren si konfirmim për profesionalizmin e kompanisë, pasi që punëtorët tuaj posedojnë kualifikime relevante, të azhurnuara dhe ndërkombëtarisht të njohura.



Standard për rekrutimin e punonjësve

Kompanitë janë duke e kërkuar certifikimin e ECDL-së si standard për punonjësit që synojnë të bëhen pjesë e organizatës, për të siguruar në këtë mënyrë nivelin e dëshiruar të kompetencës digjitale në nivel organizate. Po ashtu ECDL është një mjet efektiv i organizatave për ta matur efektivitetin e trajnimeve për përdorimin e kompjuterit dhe për të gjykuar rezultatet e trajnimit të jashtëm, apo të brendshëm të organizatave.

Testet e organizuara nga ECDL Kosova janë shumë të përshtatshme për t'u përdorur si mjet për përzgjedhjen dhe rekrutimin e punonjësve të rinj. Për më tepër, testet para-vlerësuese, të cilat janë të përgatitura sipas kërkesave të kompanive, mundësojnë diagnostifikim efikas të shkathtësive të stafit tuaj:

- para fillimit të trajnimeve
- në fazën e rekrutimit
- në procesin e riorganizimit.

Këto teste janë tërësisht të automatizuara. Përgatitja dhe ekzekutimi i tyre mund të përfshijë module të tëra apo edhe teste të individualizuara konform kërkesave të organizatës.

Deri në vitin 2015 për rreth 90% të vendeve të punës do të nevojiten shkathtësi digjitale. Por që tani në Evropë ekziston një deficit substancial për «e-skills». Komisioni Evropian, "Monitoring e-skills Demand and Supply in Europe".



Përfitimet për Kompaninë Tuaj

Përfitimet kryesore nga certifikimi i stafit tuaj me ECDL janë:

- Rritje e produktivitetit dhe efikasitetit
- Zvogëlim i kohës së shpenzuar në përkrahje teknike dhe përfitim i kohës shtesë për punë kreative dhe inovacion
- Krijimin e përparësive të qëndrueshme konkurruese të organizatës
- Rritje e motivimit të stafit si rezultat i ngritjes së nivelit të kompetencës digjitale të tyre
- Reduktim i numrit të gabimeve dhe prishjeve
- Zvogëlim i nivelit të stresit në punë, i cili zakonisht ndërlidhet me mungesën e shkathtësive adekuate
- Rritja e sigurisë tek punëtorët
- Rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve të kompanisë tuaj
- Rritjen e kompetencës në treg

Për ne

ECDL Kosova është autoriteti nacional certifikues i autorizuar nga ECDL Foundation për Republikën e Kosovës. ECDL Foundation është autoriteti mbikëqyrës i programeve certifikuese, ndërkombëtarisht prijëse, të shkathtësive kompjuterike – ECDL/ICDL. Cilësia dhe reputacioni i programeve tona certifikuese janë të ndërtuara mbi përvojën e gjatë në shpërndarjen e suksesshme të programeve certifikuese të TIK-ut miliona njerëzve anembanë botës në më shumë se 41 gjuhë të ndryshme dhe në mbi 150 shtete. Suksesi global i ECDL-së rrjedh nga roli ynë nismëtar në identifikimin dhe zhvillimin e programeve si dhe përkushtimin tonë për të siguruar metodologji testuese që, në mënyrë të vazhdueshme, i zbatojnë standardet më të larta të cilësisë.

Programet certifikuese të ECDL-së në Kosovë janë të njohura nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Universitetet Publike dhe Private dhe një numër i madh i organizatave dhe institucioneve private e publike (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Policia e Kosovës, FSK, Inspektorati Policor, Autoritetet Rregulluese, Firma e Organizata private e jo-qeveritare).

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Integritimit Evropian përmes planit për veprim PVPE 89/2 e pozicionon ECDL-në si standard certifikues për të gjithë shërbyesit civil. MASHT, duke filluar nga viti 2009 e ka përfshirë certifikimin ECDL Standard si masë obliguese për licencim për të gjithë mësimdhënësit e shkollimit para-universitar.

A mund të ju ndihmojmë?

Për çfarëdo informate shtesë jemi në dispozicionin tuaj në çdo kohë.

Ne mund të na gjeni në këtë adresë:

ECDL Kosova SH.A.

Rruga Xheladin Hana p.n. – Bregu i Diellit

10000 Prishtinë

Internet: www.ecdl-kosova.org Email: admin@ecdl-kosova.org Phone: 044-507 575